



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

---

**Datë:** 20.05.2025  
**Numër Protokolli:** 3823/2025

**A.nr.496/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.496/2025, të datës 18.03.2025, të parashtruar nga ankuesja, E.G., kundër organit të punësimit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 20.05.2025, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.496/2025, e datës 18.03.2025, e parashtruar nga ankuesja, E.G., ashtu që, aprovohet pretendimi për parregullsi ligjore, ndërsa, refuzohet pretendimi lidhur me vlerësimin e ankuesit në testin më shkrim.

**II. Anullohet** procedura e pranimit me numër reference RN00016203, për Grupin e Buxhetit dhe Financave, pozita e punës Zyrtar i Lartë për Çështje Financiare të Shpronësimeve, në Drejtorinë e Pronës, Komuna e Prishtinës.

**III. Obligohet** Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë të Komunës së Prishtinës, të ndërmarr veprimet e nevojshme administrative me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në II të dispozitivit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Kandidatja për pranim në shërbimin civil E.G.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 18.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016203, për Grupin e Buxhetit dhe Financave, pozita e punës Zyrtar i Lartë për Çështje Financiare të Shpronësimeve, të shpallur nga Komuna e Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 24.03.202, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 24.04.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova:* Ankesën me numër protokollit 1780/2025 të datës 18.03.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin për verifikim paraprak me Nr.prot. 14-111/01-0020104/25 e datës 07.02.2025; Vendimin me Nr.prot. 14-022/01-0018186/25, të datës 05.02.2025; Njoftimin me e-mail të datës 28.02.2025; Njoftim për rezultatin e testit me shkrim të datës 28.02.2025; Kopja e letërnjoftimit; Formulari i parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigjen në ankesë të datës 24.03.2025; Përgjigjen në ankesë së bashku me dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit të datës 24.04.2025; Konkursin me numër reference RN0016203, të datës 24.12.2024; Lista e aplikantëve; Vendimin për përbërjen Komisionit të Pranimit Nr.prot.14-020/04-0021944/25 të datës 11.02.2025; Akt emërimin me Nr.01-112-1006 të datës 27.01.2025; Akt emërimin nr.01-112-1054 të datës 13.12.2024; Akt emërimin me Nr.01-112-799 të datës 025.11.2024; Vendimin me Nr.14-112/02-0167529/24 të datës 19.12.2024; Akt emërimin me Nr.prot.01-112-1245/24 të datës 19.12.2024; Njoftimin për test me shkrim të datës 14.02.2025; Çelësin e esesë; Formularin e vlerësimit të esesë të datës 20.02.2025; Eseja e punuar nga ankuesja; Çelësi i pyetjeve të intervistës nga Komisioni i Pranimit; Njoftimin e datës 25.02.2025; Formularët e vlerësimit për kandidatët në intervistë me gojë të datës 27.02.2025; Njoftimi përfundimtar me numër protokollit Nr.prot. 14-111/01-0031915/25 të datës 03.03.2025; Aplikacioni i ankueses E.G së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni i kandidatit V.K së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Testi me shkrim i siguruar nga Këshilli në DMZP; Vendimin me numër protokollit 2841/2025 i Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Komuna e Prishtinës, më datë 24.12.2024, ka shpallur konkursin publik për pranim me numër reference RN00016203, për Grupin e Buxhetit dhe Financave, pozita e punës Zyrtar i Lartë për Çështje Financiare të Shpronësimeve, në Drejtorinë e Pronës, me klasë të pozitës Profesional 1, një (1) vend i lirë pune, i hapur për aplikim nga data 25.12.2024 deri më datën 23.01.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 40 kandidatë, ndër ta edhe ankuesja e cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke i plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa, e njëjta i është nënshtruar edhe fazave të vlerësimit profesional, ashtu që, në testin me shkrim ka arrit 42.4 pikë, si pikë të mjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë.

Spektori i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, më datën 03.03.2025, ka publikuar Njoftimin përfundimtar me numër protokollit Nr.14-111/01-0031915/25, nga i cili njoftim rezulton se si kandidat i suksesshëm për pozitën përkatëse është shpallur kandidati V. K. me gjithsejtë 85.6 pikë.

Pas publikimit të rezultatit përfundimtar ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se vlerësimi i testit me shkrim nuk është i drejtë dhe i saktë, njoftimi i verifikimit paraprak ka qenë i përditësuar, dhe me gabime teknike, dhe nuk ka pasuar arsyetim fare gjithashtu i njëjti është publikuar vetëm në sistem e jo sipas e-mailit zyrtar, për çka konsideron se njoftimi i tillë është bërë ekskluzivisht vetëm për kandidatin fitues. Kërkon nga Këshilli që të aprovohet ankesa si e bazuar.

Kolegji i Këshilli, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen Konkursit publik me numër reference RN00016203, në kuptim të respektimit të kërkesave të përgjithshme formale dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se pozita Zyrtar i Lartë për Çështje Financiare të Shpronësimeve është shpallur në grupin e Buxhetit dhe Financave, klasa profesional 1, ndërsa si kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Diplomë e nivelit të pestë KKK, për fushën TIK. Diplomë Universitare, Fakulteti Ekonomik, Financa apo Kontabilitet;* **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku 2 (dy) vite përvojë pune profesionale.* Pra, kriteret formale kanë qenë në pajtim me Rregulloren((QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil( *në fuqi nga data 28.302.2024*), dhe Katalogu i vendeve të Punës në Shërbimin Civil (*në fuqi nga data 23 tetor 2024*).

Në kuptim të bazushmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

- **Nenit 39** paragrafi 1: *Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përrjashtimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës. 12. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative. 13. Për të gjitha procedurat dhe gjatë të gjitha fazave të rekrutimit, aplikohet legjislacioni përkatës për parandalimin e konfliktit të interesit. 14. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor, miraton rregullat për procedurën e rekrutimit dhe vlerësimin e kandidateve/ëve sipas këtij neni. 15. Rregullat për procedurën e konkurrimit dhe vlerësimin e kandidatëve, për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet*

- **Nenit 40, paragrafi 1:** *1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë,*

*në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësuese/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen në procedurë ankimore, mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me theks të veçantë:

**-Nenin 7:** *Verifikimi paraprak 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.*

**-Nenin 8:** *Vlerësimi profesional Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj.*

**-Neni 9** *Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithësej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNj. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimit e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni behët publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.*

**-Nenin 10:** *Vlerësimi nëpërmjet intervistës 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimit njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimit i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7*

*i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimit mund të parashetrojnë edhe nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitë e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve.*

**-Nenin 11:** *Shpallja e rezultatit përfundimtar 1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat*

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor, Kolegji pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës ka konstatuar se vlerësimi i kandidatëve lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është realizuar në mënyrë elektronike, pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatet, dhe të përgatitura në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht testi ka përmbajtur 25 pyetje më përgjigje të shumëfishta dhe një pyetje në formë të eseja. Rrjedhimisht, duke u bazuar në shqyrtimin e testit të aplikuar në procedurën e kontestuar Kolegji nuk vëren të meta në vlerësimin e drejtë të ankueses lidhur me testin me shkrim, pasi që ankuesja ka dhënë 15 përgjigje të sakta duke arritur 30 pikë, ndërsa, në ese është vlerësuar me 12.4 pikë nga 20 pikë maksimale, duke arritur gjithsej 42.4 pikë, si pikë të pamjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, sikurse parashihet me nenin 9 paragrafi 4 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.* Kështu që mbi këtë bazë dhe duke qenë se vlerësimi i eses është vlerësim diskrecional i anëtarëve të Komisionit të Pranimit, atëherë, Kolegji nuk vëren nën vlerësim të ankueses në raport me esenë, dhe se pretendimi mbi këtë bazë ankimore nuk gjene mbështetje.

Në kuptim të respektimit të parimit të meritokracisë si një nga parimet bazë në procedurë të pranimit në shërbim civil, Kolegji ka analizuar dokumentacionin e kandidatit të shpallur fitues për procedurën e kontestuar të pranimit, dokumentacion ky i përcjell më përgjigjen në ankesë, ku si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se kandidati V.K. posedon Diplomën me numër Nr.2563, të datës 27.09.2012, për përfundimin e studimeve themelore më datë 07.06.2012, në Fakultetin Ekonomik, Departamentin Menaxhment dhe Informatikë, Universiteti i Prishtinës, duke marrë titullin Bachelor për Menaxhimin dhe Informatikë, Certifikatën me reference 19/2014 të datës 24.09.2014, nga Kolegji Gjilani për gradën Master-MA në Menaxhment, Specializimi: Ndërmarrësi, ndërsa, përkitazi me kriterin e përvojës së punës pas diplomimit ka bashkangjitur Vërtetimin të datës 12.12.2016 të lëshuar nga Sh.p.k Krasniqi, më të cilin dëshmohet se ka qenë në marrëdhënie pune në pozitën Zyrtar Financiar, pranë kësaj kompanie dhe atë në periudhën nga data 03.07.2012 e tutje; ndërsa, këtë përvojë punë nuk e ka dëshmuara më Pasqyrë të Trusit Pensional apo dëshmi nga Administrata Tatimore. Posedon edhe Vërtetimin me numër protokollit Nr.2135 të datës 09.12.2024, të lëshuar nga Drejtori i Departamentit të Administratës, të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë me të cilin dëshmohet se kandidati nga data 11.05.2017 deri më 01.07.2023, ka qenë i emëruar në pozitën e punës Arkatar në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik.

Rrjedhimisht, referuar dëshmime të analizuara si sipër, Kolegji konstaton se kandidati V.K., i deklaruar si kandidat i suksesshme, nuk ka plotësuar kriteret formale të përgjithshme për pozitën Zyrtar i Lartë për Çështje Financiare të Shpronësimeve, sepse, ankuesi si fushë të arsimit ka Fakultetin Ekonomik Drejtimi Menaxhment dhe Informatikë, ndërsa, siç u specifikua më lartë, për pozitën përkatëse si fushë e arsimit është përcaktuar Fakulteti Ekonomik drejtimi Financa apo Kontabilitet. Po ashtu, i njëjti nuk ka dëshmi se nuk ka në fuqi ndonjë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik, si një nga kërkesat e përcaktuara me pikën 5 të konkursit.

Bazuar në konstatimet dhe rrethanat si më lartë, Njësia Përgjegjëse në këtë rast Njësia e Personelit të Komunës së Prishtinës, nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale duke përfshirë kandidatin V.K. (i shpallur edhe kandidat fitues), në listën e kandidateve që ka plotësuar kriteret formale të konkursit, veprime këto në kundërshtim më nenin 39 paragrafi 7 pika 7.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik. Andaj, duke qenë së sipas Renditjes përfundimtare pa datë dhe nënshkrime, vetëm kandidati V. K. ka arritur numrin e pikëve të mjaftueshme për tu shpallur si kandidat i suksesshëm dhe njëherazi i shpallur edhe si kandidat fitues, mirëpo, meqenëse i njëjti siç u konstatua më lartë nuk ka plotësuar kriteret formale për pozitën përkatëse të shpallur, atëherë, në mungesë të kandidatëve tjerë të suksesshëm, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrejdhimisht e aprovoj ankesën si të bazuar dhe anuloi në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00016203, për Grupin e Buxhetit dhe Financave, pozita e punës Zyrtar i Lartë për Çështje Financiare të Shpronësimeve, të shpallur nga Komuna e Prishtinës.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*Lënda:A.nr.496/2025*

**Kaltrina Avdullahi-Prenaj**

*Procesmbajtëse*

**Ardita Haxhnikaj Demi**

*Kryetare e Kolegjit*

### **Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses, E.G.;
- Njesisë se Personelit në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.